



VENDIM

Nr. 93 Datë 26.09.2011

**PËR
SHTYRJEN E AFATIT TË LIÇENSËS NR. 64, E DHËNË ME
VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE NR. 90, DATË
06.08.2008 PËR “BIOPOWER GREEN ENERGY”**

Në mbështetje të neneve 9, 13 pika 1, gërma “a”, dhe 15 të Ligjit Nr.9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 121 dhe 128 të Ligjit nr.8485, datë 12.05.2008 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 26.09.2011, mbasi shqyrtoi informacionin e Drejtorisë së Licensimit dhe Monitorimit të Tregut për shtyrjen e afateve për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE shoqërisë “BIOPOWER GREEN ENERGY” sh.p.k,

Dhe duke konsideruar :

Kompleksitetin e problematikes që i licensuari ka hasur për fillimin e punimeve për ndërtimin e centraleve, me erë “BPGE 1” dhe “BPGE 2” për shkak se ende nuk ka marrë autorizimin e Linjës Tregëtare nga pala italiane, duke qene se ndertimi i lijave të interkonjeksionit, përveç etapave administrative në të cilat kalon çdo projekt përbën akoma një teknologji jo shumë të njohur në vend dhe që kërkon asistencën teknike të huaj,

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Në vendimin nr.90, datë 06.08.2008, për dhenien e licensës shoqërisë ”Biopoöer Green Energy” sh.p.k në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë dhe prodhimin e energjisë elektrike nga parqet Eolik “BPGE 1” dhe “BPGE 2”, të bëhen këto ndryshime:

Pika 1 gërma “e” të ndryshohet si më poshtë:

e.1 Afati i fillimit të punimeve për realizimin e projektit do të jetë në përputhje të afatit të përcaktuar ne lejen e METE-s nr. 4/1, datë 07.12.2009, të miratuar me VKM nr. 31, datë 20.01.2010, te ndryshuar me VKM – ne Nr. 542, date 27.07.2011, per ndertimin e Linjes Tregtare te Interkonjeksionit me rryme te vazhduar ndermjet Kallmet/ Lezhe dhe Zapponeta/Manfredonia.

e.2 Koha e zbatimit të gjithë projektit përfshirë dhe kolaudimin e veprës do të jetë 36 muaj nga realizimi i afatit te percaktuar ne piken e.1.

2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit te Tregut të njoftojë shoqerinë “Biopower Green Energy” për Vendimin e Bordit të Komisionereve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol RAMADANI